



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:095308

Datë: 14.01.2025

Numri i dokumentit: 06705935

AC.nr.2436/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS- në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fatmir Baloku, kryetar i kolegjit, Malsor Kryeziu dhe Kujtim Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditësit A.Q nga fshati ..., - Shtime, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Komisioni për Vendosje, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1027/21, të datës 07.04.2021, në seancën e kolegjit e mbajtur me datën 14.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit A.Q nga fshati ..., - Shtime, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1027/21 i datës 07.04.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1027/21, të datës 07.04.2021 Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, ka vendosur si vijon: REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit A.Q nga fshati, Shtime, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Komisioni për Vendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit Nr., të datës 07.04.2021 dhe kompensimin e ndalesës prej 25% nga paga bruto.

Kundër këtij aktgjykimi, përmes të autorizuarit të tij, paditësi në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikueshmërisë së gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që ankesën ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi apo çështja të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të LPK, ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesë dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore gjeti se:

Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës, rrjedh se paditësi me datën 19.05.2021 ka paraqitur padi kundër të paditurës për anulim të vendimit, dhe kompensimin e ndalesës së pagës prej 25%.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, në procedurën e provave ka administruar provat dhe pas vlerësimit të këtyre provave ka konstatuar gjendjen faktike prej nga ka gjetur se kërkesëpapia e paditësit është e pabazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Ndërsa në arsyetim mes tjerash ka theksuar se: Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve dhe provave të lartë cekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpapia e paditësit është në tërësi e pa bazuar. Gjykata nga provat e nxjerruara më lartë vërteton këtë gjendje faktike: paditësi për shkak të mos mbajtjes së maskës kundër pandemisë Covid 19 me datë 03.09.2020 zyrtarën policor i kanë shqiptuar gjobë, të cilën nuk e ka pranuar dhe po ashtu të njëjtën nuk ka prova se e ka paguar; se paditësi nuk është pajtuar me gjobën e shqiptuar nga zyrtarën policor kjo është evidenten me mos pranimin e saj dhe ndikimin tek shoku i tij për mos pranim; se paditësi është raportuar për sjellje të pahijshme disiplinore dhe ka marrur masë disiplinore ndalesë në pagë prej 25% të pagës bruto për dy muaj dhe suspendim të përkohshëm prej 3 ditëve; pra si zyrtra policor paditësi pa të drejtë ka kundërshtuar zyrtarët policor që ndaj tij dhe L..., të shqiptohet tiketa për mos mbajtje të maskës; po ashtu është vërtetuar se shoku i tij që kanë qenë bashkë në momentin e shqiptimit të tiketave në të kaluarën ka kryer vepra penale dhe ky fakt është imazh jo i mirë për Policinë e Kosovës. Gjykata vlerëson se me vetë faktin e mos pranimit të tiketës për shqiptimin e gjobës për shkak të mos mbajtjes së maskës, paditësi ka kundërshtuar veprimin e zyrtarëve policor dhe dëshmija e dëshmitarëve N.K dhe Rr.A është e besueshme në harmoni njëra me tjetrën dhe me provat e tjera në shkresat e lëndës. Mos pranimin e tiketës nga paditësi duke qenë edhe zyrtar policor, përkatësisht duke kundërshtuar kolegët e tij policë për shkak se të njëjtit kanë kryer detyrat e tyre të punës, kjo Gjykatë vlerëson se vendimi i kontestuar është i ligjshëm dhe konform veprimeve të paditësit ndaj zyrtarëve policor. Është vërtetuar se paditësi ka penguar dhe ka tentuar të ndikoj në vendimin e zyrtarëve policor gjatë kohës së shqiptimit të tiketës për mos mbajtje të maskës. Procedura disiplinore është udhëhequr konform nenit 43 të Ligjit për Policinë, dhe akteve nën ligjore. Gjykata vlerëson se mos pranimi i tiketës dhe mos pagimi i saj janë refuzim i respektimit të institucionit të Policisë së Kosovës dhe misionit të saj që është zbatimi i ligjin në çdo sfer të shoqërisë, pra është diskredituese dhe i shërben për të keq imazhit të Policisë së Kosovës veprimet e paditësit dhe për këtë arsye vendimi i kontestuar është i bazuar, ndërsa kërkesëpapia e paditësit e pa bazuar. Gjykata vlerëson se dëshmija e dëshmitarit L.M është subjektive dhe të njëjtës nuk ju falë besimi, për arsye se e njëjta është në kundërshtim me faktet e vërtetuar në këtë procedurë që janë vendimtare, siç janë: paditësi ka refuzuar pranimin e tiketës nga zyrtarët policor, të cilën kanë pasur për detyrë ta zbatojnë Ligjin Nr.07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid 19 në Territorin e Republikës së Kosovës, në shkresat e lëndës këtë tiketë nuk ka prova se e ka paguar paditësi, ka denoncuar zyrtarët policor në Inspektoriatin Policor, pra me këto veprime paditësi haptas ka refuzuar zbatimin e ligjit të lartë cekur. Gjykata vlerëson se vendimi i kontestuar është në harmoni me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 47. Veprimi i Zyrtarëve policor ka bazën juridike në Ligjin e Policisë neni 10 dhe Ligjin Nr.07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid 19 në Territorin e Republikës së Kosovës. **Baza juridike:** Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 47; Ligji i Policisë neni 10; Ligjin Nr.07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid 19 në Territorin e Republikës së Kosovës; Kushtetuta e Republikës së Kosovës nenet 22; 24; 31 dhe 54; Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut neni 6. Gjykata sa i përket shpenzimeve të procedurës është bazuar në nenin 450 të

LPK-së. Gjykata vërtetoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për të vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, e duke u bazuar në nenin 143 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë pasi që përfundimi dhe qëndrimi i saj juridik është i rregullt dhe i ligjshëm për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata e Apelit, vlerëson se nga ekzaminimi i aktgjykimit të ankimuar, rrjedh se gjykata e shkallës së parë, me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka vlerësuar drejtë provat dhe përmes nxjerrjes së provave, drejtë ka vërtetuar faktet që kanë rezultuar në vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe i njëjti aktgjykim përmban të gjitha arsyet vendimtare sipas nenit 160 par.4 dhe 5, dhe të njëjtat arsye të dhëna janë në harmoni të plotë lidhur me vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Të pabazuara janë pretendimet e paditësit se aktgjykimi i atakuar me ankesë, është i përfshirë me shkelje esenciale nga neni 182 par 2 pika n) dhe 0) të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, dhe se dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm dhe nuk është kontradiktor me vetvete dhe me arsyet e aktgjykimit dhe në të janë treguar arsyet për faktet vendimtare.

Gjithashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi nuk është përpiluar në përputhje me nenin 160 par.5 të LPK-së, pasi që aktgjykimi i përmban të gjitha arsyet vendimtare të parapara sipas nenit 160 par.4 dhe 5 dhe të njëjtat arsye të dhëna janë në harmoni të plotë lidhur me vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata shqyrtoj edhe pretendimet tjera ankimore të paditësit, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për vendosje ndryshe në këtë çështje kontestimore.

Nga arsyet e cekura më lartë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 194 dhe 195.1 pika d) të LPK-së Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr. 2436/22, me datë 14.01.2025

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Fatmir Baloku d.v